



Funded by
the European Union

Subkulturat Queer

Cruising-u në Prishtinë

2024

Implementuar nga:



QENDRA PËR BARAZI DHE LIRI TË KOMUNITETET LGBT NË KOSOVË (CEL)

COPYRIGHT © CENTRE FOR EQUALITY AND LIBERTY TË GJITHA TË DREJTAT E REZERVUARA. ASNJË PJESE E KËTIJ PUBLIKIMI NUK MUND TË RIPRODHOHET, TË RUHET OSE TË TRANSMETOHET NË ÇFARËDO FORME ELEKTRONIKE, MEKANIKE FOTOKOPJUESE, INCIZUESE APO NDRYSHE, PA LEJEN PARAPRAKE TË CEL KOSOVA.

CEL. Tel: +383 49 701 499
e-mail: info@cel-ks.org
web-page: www.cel-ks.org

Klauzola e përgjegjësisë

Ky publikim u financua nga Bashkimi Europian. Përmbatja e tij është përgjegjësi e vetme e CEL Kosova dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Europian.

Subkulturat Queer: cruising-u në Prishtinë.

Hulumtues

Linda Mustafa, Era Ramoja, Rea Mahmudemaj

Mentore

Prof. Dr. Linda Gusia

Universiteti i Prishtinës,
Fakulteti Filozofik,
Departamenti Antropologji dhe Trashëgimi Kulturore.
dhjetor, 2024

Hyrje

Cruising-u i referohet një praktike sociale që përfshinë kryesisht burra gej, biseksualë dhe individë transgjjinorë të cilët kërkojnë takimë seksuale në hapësira publike. Termi "cruising" nuk ka një përkthim adekuat dhe të drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe, dhe në këtë tekst, do të përdorim termin cruising në gjuhën angleze. Ndonjë herë përdoret edhe shprehja "me dalë" nga individët që e kanë praktikuar në të kaluaren, kryesisht për të përshkruar takimet në hapësira publike. Historikisht, kjo praktikë ka lindur si një përgjigje ndaj shtypjes që kanë përjetuar këto grupe, veçanërisht kur orientimet e tyre seksuale ose identitetet gjinore ishin të kriminalizuara. Në kontekstin jugosllav, në Kosovë që nga vitet e 1960-ta të qenit queer nuk është e kriminalizuar, megjithatë stigma, dhuna dhe paragjykimet janë shume të pranishme. Në Kosovë, kultura e cruising-ut ka origjinën që nga vitet 1980, duke evoluar përmes një serie sfidash socio-politike dhe strategjish të komunitetit queer për mbijetesë dhe shprehje. Deri sa praktika heteroseksuale e të dalurit në krug ka qenë e pranishme që nga vitet e 60, ky studim synon të shqyrtojë origjinat, evoluimin dhe rëndësinë e hapësirave të cruising-ut brenda komunitetit queer të Kosovës, duke u fokusuar në mënyrën se si këto hapësira shërbyen si vend-takime për individë të marginalizuar nga shoqëria heteronormative, dhe duke e parë hapësirat e rezistencës. Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të hulumtojë dhe të hedh dritë në këtë praktikë të subkulturës. Mbi të gjitha hulumtimi synon të analizojë cruising nga pikënisja që kjo praktikë shpërfaq një mbijetesë kulturore. Duke analizuar trajektoren historike të saj dhe se si hapësirat publike kanë qenë të rëndësishme për keto praktika. Pjesa më e madhe e këtij studimi do të

përqendrohet në zhvillimin e kulturës së cruising-ut në Kosovë, duke shqyrtuar vendet dhe ngjarjet kyçe që e formësuan identitetin e saj. Përmes shqyrtimit të lokacioneve dhe hapësirave formale dhe joformale, përfshirë tregjet, parqet dhe hapësirat afër ndërtesave publike, ky studim gjithashtu do të nxjerrë në pah tensionin në mes ekspozimit publik dhe rrezikut të dhunës, duke i dhënë rëndësi mënyrës se si kultura e cruising vazhdon të ekzistojë pavarësisht rreziqeve të refuzimit social, stigmes dhe agresionit homofobik.

Përmes hulumtimit kemi synuar t'iu përgjigjemi këtyre pyetjeve kërkimore:

- Cilat ishin vendet kryesore dhe hapësirat e përdorura për cruising në Kosovë, dhe si kanë evoluar ato me kalimin e kohës?
- Si e ka adaptuar komuniteti përjashtimin shoqëror dhe homofobinë përmes përdorimit të hapësirave publike dhe gjysmë-publike?
- Çfarë roli ka luajtur kjo praktikë në ruajtjen dhe forcimin e komunitetit gjatë periudhave të turbullta sociale dhe si ndikuan aktet e dhunës në sigurinë dhe dukshmërinë e hapësirave të cruising në Kosovë?

Shqyrtimi i literaturës

Pikënisja e këtij hulumtimi ka qenë percaktimi dhe perzgjedhja e fushës së hulumtimit, ku shqyrtimi i literaturës ka bërë të njohim me shumë këtë fushë. Studime ekzistuese nuk ka për kulturen e cruising në Kosovë, andaj edhe ka qenë sfidë hulumtimi i kësaj kulture në vendin tonë. Në përgjithësi, mungojnë dukshëm hulumtimet antropologjike e sociologjike për komunitetin queer.

Literatura bazë që ka shërby si referencë përgjatë hulumtimit, përveç leximeve tjera rreth gjinisë dhe seksualitetit është e mbeshtetur në:

Muñoz, J. E. (2009). *Cruising utopia: the then and there of queer futurity*. Neë York, Neë York University Press. Muñoz në këtë studim Ëme saktësisht në kapitullin, *Ghosts of Public Sex: Utopian Longings, Queer Memories* ai thekson epideminë e Aids që shpërtheu në Amerikë në vitet e 80-ta që rezultoi në zhdukjen e hapësirave dhe praktikave të cruising. Seksin në hapësirat publike Muñoz e konsideron një ikje nga shoqëria heteronormative.

"Public sex is used as a utopian escapism from the "crushing presence and alëays expanding force field that is heteronormativity"

Hulumtimi i cili na ndihmon të lokalizojmë dhe kornizojmë hulumtimin në kontekstin e rajonit është ai i Aneta L. (2019), autorja thekson se përjashtimi social i individëve queer në Ballkan, përfshire Kosovën, ka çuar në krijimin e rrjeteve "nënterre" (vend i fshehur, ku dikë ndodh ne një hapësirë që nuk është e dukshme për publikun, si një aktivitet i fshehtë ose i paligjshëm), të cilat perfshijnë cruising si një formë të angazhimit publik, por të fshehtë.

Mirëpo, në këtë studim kemi lexuar literaturë shtesë që nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me çështjet queer dhe ajo është: Hebdige, Dick. (1991). Subculture : the meaning of style. London; New York :Routledge, InternationalFoundationManifesta (2023) Mapping Subculture Movements: Prishtina: Prishtina, Kosova.

Pjesë e rëndësishme e shqyrtimit të literaturës ka të bëjë edhe me metodat e hulumtimit, hulumtimi përdor narrativat e të intervistuarve si bazë për hulumtim, dhe mbeshtetët mbi metodat etnografike dhe vëzhgimin.

Metodologjia

Për t'iu përgjigjur pyetjeve kërkimore të shtruar në hulumtim në kemi përdorur metodën e gjetjeve kualitative me teknikat e intervistës dhe vëzhgim etnografik i kryer në hapësira kyçe të identifikuara nga intervistuesit si të rëndësishme. Hulumtimi përfshinë po ashtu edhe pesë intervista gjysmë të strukturuar. Hulumtimi ka pasur si target grup pesë subjekte, të cilët kanë qenë të moshave të ndryshme dhe për të cilët kemi pasur njohuri paraprake së kanë praktikuar cruising dhe kanë njohuri rreth kësaj praktike. Këto intervista përfshijnë kryesisht burra gej, mirëpo përfshihen edhe personat biseksual dhe identitete tjera gjinore, si jo-binare dhe gra transjinore. (gjeni tabelën më poshtë)

Përpara se janë mbledhur të dhënat, është formuluar kërkesa për intervistim dhe dërgimi i saj tek pjesëmarrësit e hulumtimit nga anetarët e ekipit. Pas konfirmimit, janë realizuar intervistat, dhe transkriptuar. Për fund është bërë përpunimi dhe analizat e gjetjeve.

Në këtë studim janë ndërmarrë disa hapa për të pasur sigurinë që të gjitha standardet etike të mund të realizoheshin në mënyrën e duhur gjatë gjithë procesit, për atë arsye, emrat e subjekteve qëndrojnë anonim dhe në këtë studim referohen me iniciale. Qartësimi i qëllimit të hulumtimit, natyra vullnetare e pjesëmarrjes në studim si dhe mundësia e tërheqjes nga hulumtimi ishin edhe disa nga hapat e ndërmarrur.

Paralelisht, kemi dalur në terren, në vendet e cruising, ku kemi vëzhguar dhe definuar karakteristikat e hapësirave të cruising, kemi identifikuar moshën dominuese në këtë praktikë. Lokacionet të cilat janë akoma aktuale për praktikën e cruising janë anonime dhe me emra të trilluar për të mbrojtur vendet nga ekspozimi. Në këtë hulumtim, vendi aktual i cruising nuk do të përmendët dhe do të i referohemi si 'vrima'.

Përgjatë hulumtimit jemi udhëhequr me idenë që të mos shkaktojmë dëm dhe të mos ekpozojmë apo rrezikojmë në ndonjë mënyrë personat e përfshirë në hulumtim a po praktikën në përgjithësi.

Në tabelën më poshtë mund te shihni subjektet që janë intervistuar, profilizimet dhe hulumtuesit pergjegjës për realizimin e intervistave.

Lista e intervistave

| Emri dhe mbiemri i të intervistuarit/es dhe profilizimi | Hulumtuesi/ja |
|--|----------------------|
| 1.A.N, 53 vjeçar nga Prishtina, OJQ | Linda Mustafa |
| 2.A.R, 23 vjeçar nga Prishtina, student | Era Ramoja |
| 3.F.M, 48 vjeçar, OJQ | Linda Mustafa |
| 4.P.B, 22 vjeçar, nga Podujeva | Linda Mustafa |
| 5.XH.P, 19 vjeçare, nga Prishtina ish-punëtoreshë seksuale | Linda Mustafa |

Kronologji e sub-kulturës së cruising dhe zbërthim i hapësirave

Hapësirat e përdorura nga komuniteti për praktikimin e cruising, janë qëndrore për ta kuptuar më mirë këtë praktik në kontekstin e Kosovës. Analiza kronologjike që nga vitet e 80-ta e deri më sot, e bën të dukshme fluiditetin dhe spontanitetin e kësaj praktike, dhe zhvendosjen e një hapësirë në tjetrën në një proces organik të pa organizuar.

Në Kosovë, nuk dihet saktë se kur ka qenë eksperiencia e parë e cruising, e as nuk mund ta dijmë. Ka aq pak hulumtime për përvojat e personave queer në Kosovë sa që do të ishte e pamundur të datojmë në këtë hulumtim. Mirëpo gjendja politike dhe shoqërore e Kosovës në vitet 80-ta e tutje e spjegon qartazi që nuk ka pasë të drejta themelore për jetesë, për personat queer që kanë jetuar dhe vepruar në ato kohë. Situatat politike, normat shoqërore kanë ndikuar që personat queer në Kosovë të detyrohen të jetojnë një jetë të dyfishtë dhe si rrjedhojë të organizohen brenda komunitetit që nevojat e tyre, takimet dhe socializimet ti bëjnë fshehtaz në hapësira të ndryshme publike.

Vitet e 80-ta

Tregu i Grave - Tregu i të martëve.

Parkingu i cili sot shërben thjeshtë për parking të veturave, në vitet e 80-ta në Prishtinë frekuentohej nga shumë pjesëtar të

komunitetit. Bëhet fjalë për parkingun mbrapa pallatit të rinisë ku në vitet 1980 cdo të martë mbahej Tregu i Grave ose Tregu i të martëve. Tregu i të martëve karakterizohej me shitjen e rrobave dhe gjësëndëve tjera, pak a shumë si tregu i të dieleve në Fushë Kosovë.

Çdo të martë Prishtina mbushej me persona të cilët ndoshta nuk jetonin në Prishtinë por kishin ardhur në rolin e pazarëgjinjëve, e shumë nga ta ishin persona të komuniteteve queer, ata takoheshin me personat e komunitetit të cilit vizitonin pazarin, disa për të blerë diçka e disa për tu takuar me dikë, shumë për të dyjat arsye. Personat të cilët takoheshin në pazar, pas komunikimeve vazhdonin tek ndërtesa e cila në atë kohë ishte e bombarduar, po flasim për ndërtesën ku tani gjendet Ministria e Punëve të Brendshme.

"... d.m.th. t'martev i njekshim pazaret, kah ka pazare, a po dalum te veni, a po dalim te veni, a po takohem. U martova, u munova mi lon kto sene, nuk kom mujt mi anashkalu kto sene, edhe e kom vazhdu jeten tem te dy anshme." - F.M, Intervistuesi nr.3

"Prishtina e ka pasë t'martëve ditën e pazarit, edhe t'martëve vlojke (qyteti) prej komunitetit"-

"Ka qenë hapësira mbrapa pallatit të rinisë, parkingu i madh, komplet ajo hapësina n'at kohë ka qenë treg, i thojshin tregu i grave, si aj tregu në Fushë Kosovë, t'dieleve, i kerreve. Në mbramje janë taku."A.N, Intervistuesi nr.1

Oborri i Xhamisë të madhe.

Xhamia si instituicion religjioz, parimisht nuk pranon homoseksualitetin dhe e dënon atë me thirrje të ndryshme

publike.

Megjithatë kjo xhami ka luajtur rol të madh në organizimin e takimeve mes personave të komunitetit queer.

"Hapësirë tjetër ka qenë oborri i xhamisë të madhe në Prishtinë. Se qysh kanë guxu mu mbledh aty qajo ka qenë kureshtja më e madhe.

Mirëpo, mandej e kom kuptu prej njerëzve që e kanë frekuentu qatë pjesë, ka qenë cruising area se kryesisht kanë shku te oborri i xhamisë, kanë marrë abdes, jon kon ato qeshmet jasht n oborr edhe qashtu tu marre abdes sdi çka edhe kanë komuniku mes veti me gjuhë të trupit. Janë taku jasht xhamisë edhe kane vazhdu tjetër kah. Në oborr të xhamisë qysh m'kanë kallxu nuk kanë shku vev kur ka qenë koha për me falë namaz po edhe me nejt kshtu, edhe ka qenë vend social si drop in." - A.N Intervistuesi nr.1

"...dhe aty, n'oborr t'Xhamis, n'abdes'hane te WC-t edhe aty ku marrin abdes edhe aty kena pas takime d.m.th. t'ndyshme. Jom shku jom hi n'oborr e kom pa, se na n'at kohe nuk i ki shku direkt, po i ki shku kishe po hi n'WC, kishe po kqyri, nese t'ka kqyr e ka kthy kryt ja ke bo me kry kshtu, hajde a din, qesi senesh. Po edhe n'oborr t'xhamis."- F.M Intervistuesi nr.3

Vitet e 90-ta **Shpija e dashurisë**

Vite më vonë, vendtakimi kaloi nga Xhamia e Madhe tek Shpija e Dashurisë, nuk dihet se si është organizuar komuniteti për të kaluar nga një hapësirë në tjetrën.

A.N e cilëson zhvendosjen nga një hapësirë e cruising deri tek krijimi i tjetrës si një proces organik i pa folur e organizuar por si diçka që rrjedhë vetëvetiu.

Kur po flasim për zhvendosjen vlen të cekët se me zhvendosje theksojmë rënie e nivelit të frekuentimit të asaj hapësire e jo shuarjen e saj.

Deri sa këto hapësira kanë egzistuar paralel njëra-tjetrës njëra është bërë më e frekuentuar në periudha të caktura.

Pak më lart se xhamia e madhe, në lagjen aktash ku sot gjindet Ministria e Arsimit, ishte një shtëpi e braktisur që quhej "Shpija e Dashurisë", këtë emër ia emëruan anëtarët e komunitetit të cilët e frekuentonin. Kjo "shtëpi", po e fusim në thojza sepse realisht përshkruhet nga i intervistuari si:

"spo di cka mi thonë ndërtesë su konë po do far betoni qaty. Te ministria arsimit ku o tash, i kanë thonë shpija e dashurisë. Qaty ka qenë vendtakimi, aty edhe kanë bo seks. U kon ndërtes e braktisun. Nuk ka qenë emër i njoftun për publikun, po mrena komunitetit e kanë njoftë me qat' emër. "- A.N intervistuesi nr.1

Kjo ndërtesë nga përshkrimet konsiderohej e braktisur, pa dritare dhe dyer vetëm copë cementi ku komuniteti ndihej rehat të praktikonin cruising. Në atë vit kishte edhe hapësira tjera të cilat komuniteti takoheshin e ato ishin Busti i sotëm i Skënderbeut, ku në ato kohë nuk ishte i ndërtuar.

Pas vitit 2001, kur u përrua shtatorja e Skënderbeut, për shkak të ndërtimeve të vazhdueshme në atë rrugë, ajo hapësirë u shua si hapësirë e cruising dhe komuniteti kaloi në hapësira tjera.

Hapësira tjetër ishte po ashtu e braktisur pak më larg se qendra, në lagjën e spitalit afër urgjencës.

Theksojmë se të gjitha këto hapësira i karakterizon qasja në to, ato janë hapësira publike andaj janë të qasshme nga gjithkushi. Këto hapësira përpos që janë publike janë ose të braktisura totalisht (Shpija e dashurisë) ose janë funksionale dhe kanë flluks të madh të njerëzve (Tregu i të martëve).

Parku 2008

Hapësirë karakteristike për cruising konsiderohen edhe parqet e ndryshme, jo vetëm në Kosovë por në të gjithë vendet ku praktikohet cruising, vendet më të shpeshta janë parqe publike.

Në rastin e Kosovës, Prishtinës, pas vitit 2001 e tutje, vendi i cruising kaloi tek parku i qytetit në Velani.

Fatkeqsisht jo gjithmonë eksperiencia e cruising është e sigurtë, madje në vitin 2008 në parkun e qytetit ndodhi një fatkeqësi ku një djali të ri geji i'u është marrë jeta përderisa ai kishte dalur ta praktikojë cruising.

“Aj u kon 27 vjec, dy dit perpara e takova në XXX, edhe sikur me ditë...i thash mos dil qeto dit në cruising, se po ka që po ngucin, mas dy dite e pame n'lajme...” – A.N intervistuesi nr.1

Supozohet se viktimi i ka kontaktuar personat të cilët mund të mos kenë qenë pjesë e komunitetit që ka rezultuar në vrasjen e tij.

Pas humbjes së antarit të komunitetit i cili ishte shok për shumë që e frekuentonin atë pjesë për të njejtat arsye, Parku i Qytetit nuk ishte më vend i sigurtë për komunitetin. Dhe organikisht komuniteti kalon tek një hapësirë e re, pothuajse e ngjajshme që konsiderohet po ashtu park.

Vrima

Vrima është hapësira që i ka mbijetuar kohës që nga viti 2008 e deri sot ajo akoma përdoret si vend për praktikimin e cruising. Bëhet fjalë për parkun tek vrima vend ky i cili nga viti 2008 e tutje shërben si hapësirë publike e sigurtë për vendtakim të personave të komunitetit queer.

“...kur fillova mu shoqnu me komunitetin qat here n’fillim, m’tregun që vrima osht’ ni’ vend ku ta jep mundsin edhe me ec qysh ti nihesh, edhe me gjet at fatin e jetes.” - P.B Intervistuesi nr.4

Po ta shohësh në këtë mënyrë Vrima po përshkruhet si një utopi, një botë ku ti pranohesh e mund të dashurohesh e të gjesh “Fatin e jetës”.

“... Edhe po shkojna te veni ku e bojn seksin (vrima) edhe po vazhdojna mu puth, mu përçaf edhe jom ni shum shlir n’fakt me t’kallxu t’drejt. Ish terr po m’ra n’sy kur na pi dhezim tash telefonat m’ja dhon njoni tjetrit snapin, kish pasë shumë kondoma e sene tjera (tek vrima ku është kry aktiviteti seksual)

...edhe qaty tani më se e verifikova që qaj ven osht’ i posaqëm për neve edhe i sigurt n’fakt për neve se s’kisha ni ma përpara për qit ven edhe s’kisha ni që kallxojke kush për naj sen homofobik.” - P.B Intervistuesi nr.4

Karakteristikë e këtyre hapësirave është ndriqimi i pakët për të mos thënë që është errësirë e plotë që ndikon në sigurinë e identitetit të personave të cilët e frekuentojnë këtë hapësirë për qëllimet e cruising.

Gjelbrimi dhe natyra që e percjellë këtë hapësirë realisht

punën tonë në terret e ka bo më të këndshme, duke cituar një të intervistuar.

“ D.m.th kur ti del te vrima ti del fizikisht edhe e sheh krejt ambientin, e sheh krejt atë qetsin edhe natyrën a po din..? që ta jep ma s’pari ni, ni përshtypje shumë t’mirë edhe rahat. kur tani ti vazhdon ulesh, rrin, bon llaf shlir kesh, kshtu edhe e sheh që edhe kalimtart e rastit nuk po t’kqyrin me at shikimin homofobik, “- P.B Intervistuesi nr.4

Në mes të pemëve tek afër vrimës mund të gjesh ndonjë ulëse ku njerëz të ndryshëm mundën me u ulë me folë e me pasë sado pak një moment intim, coftë ai shoqëror ose seksual.

Toaletet Publike

Toaletet Publike në qytete të ndryshme njihen si vende të praktikimit të cruising, sidomos toaletet publike në stacion të autobusëve, ku ka fluks të madh të njerëzve. Nëse vizitoni toaletet publike në Stacionin e Autobusëve në Prishtinë, në dyert e toaletit për meshkuj, janë të gdhendura numra të ndryshëm të telefonit, të cilët po kërkojnë të takojnë burra tjerë gej. Bashkë me numra të ndryshëm gjejmë dhe snapchat dhe rrjete tjera sociale bashkë me spjegime të pamjes së tyre, psh jam shumë i bukur, ose sa të gjatë janë etj.

“D.m.th ku ka pas dicka publike na qaty jena shku, se nuk o kon si ka pas siguri, nuk e kena kqyr sigurin kerkun. A ka siguri a s’ka... (veç) a ka naj ven ku munem me taku dikon. O kon te stacioni i autobusav në Prishtinë, te stacioni i autobusav n’Mitrovic, n’Peje, cdo stacion i autobusav, trenit ose dikun ku ka WC publike ke mujt me taku komunitetin LGBTI.”- F.M

Intervistuesi nr.3

Intervistuesi thekson lidhjen e fortë që ka komuniteti me hapësirat publike, duke theksuar se, shpesh, ata kanë rrezikuar sigurinë e tyre për t'u takuar dhe për t'u lidhur me individë të tjerë të komunitetit. Përmes shprehjes *"a ka siguri a s'ka, (veç) a ka naj ven ku munem me taku dikon,"* ai thekson një guxim të madh, ku anëtarët e komunitetit janë të gatshëm të sakrifikojnë sigurinë e tyre për të krijuar mundësi takimesh.

Dimensionet kulturore te praktikës cruising.

Ky hulumtim ka pasur për qëllim të paraqes disa aspekte sociale e kulturore të praktikës së cruising në Kosovë. Atë se çfarë meton të siguroj cruising pos si një akt rutinor për antarët e komunitetit është edhe një lloj nevoje e individëve për hapësira për shprehjen e identitetit të tyre seksual në një shoqëri që ka qenë e strukturuar mbi parime heteronormative.

Përvojat e të intervistuarve ofrojnë një pasqyrë për dimensionet kulturore të identitetit, socializimit dhe rezistencës ndaj stigmatizimit dhe diskriminimit. Përshkrimi i hapësirës ku praktikohen takimet seskuale si një vend ku individët gjejnë qetësinë, bëhet një vend ku individët mund të përjetojnë një ndjenje të sigurisë dhe paqes, larg shikimeve homofobike dhe presionit shoqëror. Kjo është e lidhur me një nevojë për të shfaqur veten në një mënyrë që përputhet me dëshirat dhe nevojat personale, duke ndihmuar në formimin

e një identiteti të pranuar brenda një hapësire të sigurt. Kjo përvojë është thelbësore për ta ne vetëvlerësimin dhe pranimin në një shoqëri që shpesh është homofobike dhe e papërgaditur për të pranuar diversitetin seksual. Një tjetër gjetje që del nga intervistat është ai i sekretimit dhe maskimit të identitetit. Kjo nënvizon realitetin që shumë individë janë të detyruar të bëjnë jetë të dyfishtë. Përvoja e individëve që ndihen më të sigurtë dhe të pranuar në një kontekst të fshehur si praktikimi i cruising është një mundësi për të përjetuar kënaqësi dhe lidhje, pa pasur frikë nga gjykimi apo represioni.

Unë realisht kom dale, po familja ime që osht' shumë transfobike, nuk m'ka jep t'ardhura ekonomike, e kam bërë nga zori, prostitucionin, jo prej dëshirës sime. Jo se m'kan thon mu, po kom dal kshtu. - XH.P Intervistuesi nr.5

"D.m.th kur ti del te VRIMA ti del fizikisht edhe e sheh krejt ambientin. E sheh krejt at qetsin edhe natyren a po din, që ta jep ma s'pari ni, ni përshtypje shumë t'mirë edhe rahat, Kur tani ti vazhdon ulesh, rrin, bon llaf shllir, kesh, kshtu edhe e sheh qe edhe kalimtart e rastit nuk po t'kqyrin me at shikimin homofobik, Edhe me personat që t'vin për me t'lyp për seks e kshtu, ata jon real d.m.th. ti s'munesh mi thon dikujna që jo valla nuk osht' ftyr e tinaj, se ai t'vjen edhe fizikisht edhe e sheh..." -

"unë jom dal para katër [4] vjete edhe kur fillova mu shoqnu me komunitetin qat here n'fillim, m'tregun që VRIMA osht' ni' vend ku ta jep mundsins edhe me ec qysh ti nihesh, edhe me gjet at fatin e jetes...amo me kallxu tash realitetin e nijsha veten sigurt, qekjo ish arsya pse un dilsha, edhe mu doke sikur veç qaj ven po më kupton mu edhe pe din që un jom qik. Edhe po m'pranon si qik, edhe ato andrrat e mija që po vjen frajeri jem e kshtu, a po din.."P.B Intervistuesi nr.3

"Kurioziteti, me dit çka edhe qysh ndodh. Atraksioni ndaj burrave ma të vjetër edhe burrave të martum, se e kom pas ni' faze n'jetë që qeta burra m'kan interesu edhe m'kan tërheq ma shumë seksualisht, edhe e disha që qaty muna me gjet presumingly qesi llojë njervz pak ma shumë se sa njerëzit tjerë. E treta, a din qajo, ëm, jo, nifar frike, a din tu u rujt si prej tjerëve, nifar ideje të sekretit you knoë, menoj që qajo osht' pak e glorifikume kshtu në gay ëorld, a din mi bo senet si në ni secretive ëay a din'. Edhe also qajo o kon. Menoj që qeto tri[3] arsye."- A.R Intervistuesi nr.2

Intervista 4

"Nuk e di mu m'ka pelqy nashta kajher edhe veq per ni fjal goje, veq per me fol mu shpreh me dikon, se jena taku d.m.th. je dal n'van t'caktum e ke dit si ki me taku dikon edhe ki me fol per jeten tone n'lidhje me qit komunitetin. Ka ndodh une i kom hyp kerri jom ardh n'Prishtin veq per me fol me qeta, komunitetin gej, veq me fol me ta, me bo ni muhabet edhe sem ka interesu per mardhanie seksuale. Po je i heqt kajher, s'ke dit me kon me fol, kajher ka vyft me fol me dikon, ti me familje s'ke mujt mu shpreh, me shoqni streightera s'ke mujt mu shpreh, u duft p.sh. I kom hyp kerri kom ardh te vrima veq me nejt edhe me bo llaf. Edhe s'kom bo seks." F.M intevistuesi nr.3

Rituali dhe praktika

Në një hapësirë publike ku individët mund të jenë të ekspozuar ndaj ndjekjes ose gjykimeve, shenjat janë mjet për të krijuar siguri. Ato mund të përdoren për të sinjalizuar miratimin e një ndërveprimi të mundshëm pa e bërë atë të dukshëm për të tjerët që ndodhen në të njëjtën hapësirë. Të intervistuarit përmendin se në shumë raste, mund të bëhen **"kruga"** ose të ecet rreth një zone pa asnjë fjalë, thjesht për të parë dhe për të vlerësuar se kush mund të jetë i interesuar, duke ruajtur kështu një nivel sigurie dhe anonimiteti. Duke marrë parasysh që komunikimi i hapur mes personave të komunitetit ka rrezikuar identitetin e tyre, në këtë kontekst, shenjat jo-verbale mund të jenë edhe një strategji mbrojtëse, pasi ndihmojnë individët të testojnë interesin e të tjerëve pa rrezikuar një konfrontim të drejtpërdrejtë që mund të shpjerë në shqetësime ose rrezik. Më lartë përmendëm hapësira të ndryshme publike ndër to edhe Xhamia e Madhe e Prishtinës. Pra komunikimet janë bo me gjeste dhe prekje të trupit si ftesë për takim, duke vazhduar në një hapësirë adekuate, në rastin e xhamisë tek banjot publike ku mirrej abdes. Bisedat mes praktikuesve të cruising janë të pakta mos të themi se nuk bisedojnë fare.

"D.m.th. doren te veni, te penisi doren, tu kqyr me sy, tu bo me kry, a po vjen knej, edhe je shku d.m.th ke ba seks pa kurrfar mbrojtje ateher se s'kom dit as se duhet mu mbrojt as cka duhet, po zoti na ka ru." – F.M Intervistuesi nr.3

Për të gjetur mundësi për ndërlihdje intime, individët e përshkruajnë si një pjesë të rëndësishme të ritualit vrojtimin e hapësirës përreth. Kjo përfshin analiza të kujdesshme të situatës dhe të njerëzve që mund të jenë të interesuar, si dhe

vlerësimin e mundësive që ofrohen. Vrojtimi është një mekanizëm strategjik për të kuptuar "përputhshmërinë" e mundshme dhe për të vlerësuar mundësitë për interaksione seksuale. Në këtë praktikë, komunikimi përmes sinjaleve dhe veprimeve jo-verbale është i rëndësishëm. Për shembull, mund të përdoren pyetje direkte ose sinjale fizike si prekja e organit gjenital për të shprehur interesin seksual. Këto sinjale janë të koduara dhe shpesh të pashkruara për ata që janë të njohur me këtë kulturë, por mund të jenë të paqarta ose të papranueshme për individë jashtë këtij konteksti.

Ma s'pari ti e bon nifar, ëm, tenton mos me, mos me tregu shumë ftyrën tonde. Tenton mu masku. Like jo mu masku, po si, like ku di une, nëse e ki ni' duks, me vnu', me qit kapuqin, ose a din' diçka e till, që me identifiku vetën sa ma pak që është e mundshme. Edhe para se me u afru te hapsira ti e bon' nifar vrojtimi, kshtu' të lirë të hapsirës a din'. Me kqyr kush, çka munet me pas and everything out...Edhe ça' ndodh osht' që ti afrohësh, shkon tu afru, edhe masanej ti veç bon kruka qandej, veç bon xhiro, xhiro afer qasaj rrugës. Ose mundesh mu ul nëpër benches që jon' andej edhe dikush munet me t'approach ty. Tash kur t'approach-in njerëzit munen me t'approach për cigare, munet me ta bo naj pyetje direct, munet me t'bo naj pyetje, a din, ku di unë, a je aktiv, pasiv, ose ça' ki dal ktu, për çka je?

"Po krejt n'varet prej personit, për shembull ka raste kur t'hyn, a din ta bon, ëm ku di unë, prej ça' ke dale, prej kahit je, sa vjet l ki, like ëhat's your sexual position. A din. Masanej qeshtu tu fol shkon n'bar, edhe masanej if anything, ta bon a din, a shkojm ma andej. Masanej ka raste të tjera me t'cilat ti hiq nuk flet, a din. Veç je pa në sy edhe e ke kuptu. Për shembull ka raste kur edhe dikush osht tu ec qeshtu diçka, e prekin organin gjenital edhe ta jep si shenjë, si signal që this is ëhat

I'm trying to do." - A.R Intervistuesi nr.2

Komunikimi nëse nuk qenë përmes gjuhës së trupit, prap se prap ka qenë i koduar në atë mënyrë që të mos kuptohet identiteti i vërtetë i personit.

Komunikimet e tilla shpesh shërbejnë për të përcaktuar preferencat seksuale, pa pasur lidhje me identitetet e vërteta të individëve që janë pjesëmarrës. Për këtë arsye, deri para disa kohësh, ata që praktikonin cruising nuk njiheshin mes tyre as me emra, por shpesh përdornin pseudonime ose nofka. A.N. thekson se, gjatë 15 viteve të fundit, ka pasur një rritje të hapjes dhe lirisë për të folur rreth identiteteve të tyre, një ndryshim i dukshëm nga periudha e mëparshme kur ato identitete mbaheshin fshehur. Edhe kur komunikimi nuk ka ndodhur përmes gjuhës së trupit, ai ka qenë gjithmonë i koduar, për të ruajtur anonimitetin dhe për të shmangur zberthimin e identitetit të vërtetë të personave të përfshirë.

"Rast interesant osht, në fillimet e një organizate për komunitetin, në ni hapësirë ku komuniteti socializohej, fillun me ardhë njerëz që praktikonin cruising, ata tu e taku njoni tjetritin aty po tu mos ja ditë emrin e njoni tjetrit, edhe pse janë taku sa e sa herë gjatë cruising. Ja bon njoni atij tjetrit, a Suqica je ti a? Mandej u rinjoftun me emra t vërtetë" - A.N Intervistuesi nr.1

Pra A.N flet për kodimet e emrave për të mbrojtur identitetet e njëri tjetrit nga shoqëria. Në rastin më lart, dekodojmë emrin Suqica, i cili në serbisht do të thotë Diell, personi që e kanë thirrë Suqica ka jetu në lagjën Bregu i Diellit në Prishtinë, andaj e kanë thirrë Diell, duke mos e ditur emrin e tij të vërtetë.

Rrezikimi i zhdukjes së nën-kulturës cruising

“Teknologjia o tu e zhduke kulturën e cruising, se so tu e lehtesu hic, nashta ni kohe edhe e ka lehtesu,(sepse) njerezit jon ni niher ma t sigurt niher me komuniku n dating apps e mandej mu taku live, mirepo po vrehet ashiqare qe o numer shum i vogel i njerzve qe dalin(në cruising) dmth u zvoglu ne menyre drastike, gjeneratat e reja su ni takon aty shume rralle aty ktu njo” - A.N intervistuesi nr.3

Jo rastësisht gjatë hulumtimit, gjatë punës në terren, vendet e cruising po frekuentoheshin nga një moshë e caktuar, kryesisht ish burra në moshën 40-60 vjeqare, të cilët janë largë nga teknologjia.

Aplikacionet si Grindr, Tinder, Snapchat etc dhe qasja e lehtë në to kanë rezultuar në mos-praktikimit të cruising duke qenë se takimi me persona tjerë të komunitetit fillimisht online, i ka zëvendësuar takimet spontane në vendet e cruising. Grindr është ndër aplikacionet e pakta për komunitetin queer, i cili u bë i qasshëm që nga viti 2009 dhe tani ka më shumë se 13 milionë përdorues aktiv. Nga zhvillimi i aplikacioneve të tilla, shumë persona nuk e praktikojnë më cruising pasi që e vlerësojnë si më të sigurtë komunikimin online.

Megjithatë, siç e cekëm më lartë, cruising si praktikë është kulturë që mishërohet dhe praktikohet gjeneratë pas gjeneratë, tek disa persona, mbizotëron dëshira për të praktikuar cruising pavarësisht lehtësisht të komunikimeve mes komunitetit queer.

Në këtë hulumtim, tek pjesa e faktorëve që ndikojnë në mirëmbajtjen e kësaj kulture, theksuam se kontribuon edhe shoqëritë shtypëse dhe diskriminuese ndaj komunitetit queer,

mirëpo, marrim shembull shtetet Skandinave, ku të drejtat për komunitetet LGBTI+ janë të avancuara dhe kultura e cruising akoma ka mbijetuar.

“Nuk osht’ n’zhdukje as nuk ka mu zhduk kerkun se osht’ gjethka n’bot, edhe n’Evrop edhe gjethkun jon venet ku frekuentohen, ku dalin geja, ku njoftohen edhe jasht rrjeteve sociale, d.m.th. e ki neper Skandinavi, neper tjera vende gjethka ki, neper parqe neper, se o met mentaliteti i vjeter edhe ai s’munet mu harru kurr se osht’ qashtut, osht’ edhe fizikisht, munesh me nxon nashta ma mir se me grinder”-F.M Intervistuesi nr.3

“...gjithmone ka m u kone ni grup i njerzve qe kane me dashte mu kone pjese e cruising, mendoj qe njerzt e adhurojne cruising edhe ka njerz qe mujn me t’jep tamon insight pre mrena, e un mendoj qe gjithmone ka me pase se sot e asaj dite edhe shtetet ma t zhvillume ku pranimi io n nivel egzistojne cruising areas, psh n suedì norvegji...Pse? Se mendoj qe u kriju kulturë edhe ajo trashëgohet te dikush, te dikush zhduket, se o itneresant per dikon, edhe nashta o hala ma interesant kur je free edhe ski nevoje mu mshef. Nashta vendet s’kane mu perdor mo per seks po kane mu kon vende qe kane mu mbledh njerzt.”- A.N intervistuesi nr.1

“Ajo vazhdon si kulturë, trashëgohet, prej gjenerate n gjeneratë. Edhe te na nuk besoj se hupë se hala o herët mu hupë ki gjenerata të reja që e praktikojnë. Ka me zgjatë te na.” - A.N

Gjetjet kryesore

Gjetja 1. Cruising shihet si praktikë e lidhur ngushtë me hapësirat publike ku praktikohen takimet seksuale si vende ku individët mund të përjetojnë një ndjenjë të sigurisë, larg shikimeve homofobike dhe presionit shoqëror. Kjo është e lidhur me një nevojë për të shfaqur veten në një mënyrë që përputhet me dëshirat dhe nevojat personale, duke ndihmuar në formimin e një identiteti të pranuar brenda një hapësire të cilët ata e konsiderojnë të sigurt.

Gjetja 2. Diskursi, shenjat e praktikave të lidhjeve me cruising shpërfaqin simbolet e kësaj subkulture.

Gjetja 3. Disa prej hapësirave publike, rregullave e praktikave të lidhjeve me cruising, dalin se nuk praktikohen më, disa janë refuzuar e disa janë ruajtur. Prej viteve të 80-ta, kjo praktikë ka pësuar ndryshime, sic janë: hapësirat, kalimi nga një hapësirë në tjetrën dhe ruajtja e identitetit, kodimi i emrave nuk përdoret më, ose të paktën nuk është aq i zakonshëm.

Gjetja 4. Pavarësisht avancimit të teknologjisë dhe shoqërisë, kultura e cruising është trashëgimi shpirtërore e komunitetit queer që pasohet nga gjenerata në gjeneratë andaj edhe supozojmë se zhdukja e kësaj praktike nuk do të ndodhë për një periudhë të gjatë kohore.